

VENDIM
Nr.677, datë 18.2.2008

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN PRIVAT SATELITOR “TV VIZION+”
SUBJEKTIT: “MEDIA VIZION SHA”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 24 dhe 136 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizionë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “Media Vizion” sh.a. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat satelitor për një periudhë prej 8 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Licenca me nr.038/TVL, për subjektin televiziv privat vendor “TV Vizion+”, bëhet e pavlefshme.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.